

## **Komuna e Gjilanit:** **problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

### **Hyrje**

1. Komuna e Gjilanit në gjashtë vitet e fundit qeveriset nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe kryetari nga radhët e saj Qemajl Mustafa. Z. Mustafa është në koalicion të gjerë me subjektet tjera politike si Aleanca Kosova e Re (AKR), Partia e Drejtësisë (PD), Partia Social-Demokrate e Kosovës (PSDK) dhe Partia Turke Demokratike e Kosovës (KDTP). Pozita e nënkryetarit të komunës i takon AKR-së, pozita e zëvendës kryesuesit të Kuvendit Komunal i takon KDTP-së.
2. Në vitin 2000, Kryetar i Komunës së Gjilanit ka qenë Lutfi Haziri nga LDK, i cili ka vazhduar edhe në mandatin e dytë 2002 – 2004. Nga viti 2004 deri në vitin 2007 ka qeverisur në krye të Gjilanit bashkë-partiakut i Hazirit, Xhemajl Hyseni. Nga 2007 me Gjilanin udhëheq PDK dhe Kryetari Qemajl Mustafa. Sipas UNDP, 62% e qytetarëve të anketuar të Gjilanit janë të kënaqur me punën e Kryetarit Mustafa (mesatarja e Kosovës është 69%).<sup>1</sup>
3. Komuna e Gjilanit ka gjithsej 42 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Gjilanit ka 90.178 banorë, të organizuar në 17.048 ekonomi familjare. Gjilani radhitet i pesta në vend për nga numri i popullsisë, pas Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjakovës.
4. Sipas Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Gjilanit, mbi 3.000 biznese operojnë në këtë komunë, ku afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 13% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 10% në prodhimtari dhe pjesa tjetër në transport.<sup>2</sup>
5. Sipas një hulumtimi të Institutit GAP, në fund të vitit 2009, katër problemet më të mëdha me të cilat përballëshin qytetarët e Gjilanit ishin: kundërmimi i ujërave të zeza, komunikacioni i dendur,

<sup>1</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 43. Burimi: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Albanian\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf)

<sup>2</sup> Komuna e Gjilanit. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve. 2014-2016. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Decisions.aspx>

mungesa e parkingjeve, humbja e tokës bujqësore, dhe mos zhvillimi ekonomik.<sup>3</sup>

## Problemet kryesore të Komunës së Gjilanit

- 1. Mungesa e ujit të pijes dhe cilësia jo e mirë e ujit nëpër fshatra.** Shumë fshatra të Gjilanit nuk kanë rrjet të ujësjellësit apo nuk janë të kyçura në ujësjellësin publik. Ujin e pijes e sigurojnë nga hapjet e puseve dhe kanaleve tjera të ujitjes. Përgjegjësit e ujësjellësit “Hidromorava” kanë konstatuar se në këto fshatra cilësia e ujit nuk është e mirë dhe është dhënë rekomandimi për mos përdorimin e tij për pije. Edhe përkundër kësaj, në të gjitha këto fshatra ky ujë përdoret për pije.<sup>4</sup> Nga ana tjetër, të dhënat nga hulumtimi i UNDP tregojnë se 15% e të anketuarve në lidhje me ujësjellësin publik, kanë pohuar se uji i çezmës është i turbullt, 6% se shtypja e tij është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, 14% se uji ka shije të keqe dhe 12% se ka erë të keqe.<sup>5</sup> Të gjitha këto shifra tregojnë për pakënaqësinë e qytetarëve mbi cilësinë e ujit të pijes dhe nevojën e intervenimit të Komunës në përmirësimin e këtij problemi.<sup>6</sup>
- 2. Infrastruktura jo e mirë rrugore.** Në disa fshatra të Komunës së Gjilanit mungojnë rrugët e asfaltuara. Banorët e fshatit Kravaricë ka tri vite që në vazhdimësi kanë kërkuar asfaltimin e rrugës së fshatit, por kjo nuk ka ndodhur. Ngjashëm është situata edhe në fshatin Lipovicë, Shillovë, Stançiç, Ponesh.<sup>7</sup> Edhe njëra ndër rrugët kryesore në qytet “Madeleine Albright” është e dëmtuar. Asfalti është dëmtuar edhe në rrugën “Enver Miftari”, rrugë e cila lidh qendrën e qytetit me rrugën qarkore.
- 3. Kanalizimet dhe kundërmimi i ujërave të zeza.** Qyteti i Gjilanit vlerësohet të ketë rrjet të kanalizimit përgjithësisht jo funksional. Gjatë reshjeve të shiut, qyteti shpesh vërshohet nga uji si pasojë e pamundësisë së gypave të kanalizimit për të thithur ujin e shiut. Gjatë reshjeve, rruga kryesore përballë teatrit të qytetit, rruga

<sup>3</sup> Instituti GAP. Gjilan – Raporti Komunal. Nëntor 2007.

<sup>4</sup> Agjencia e lajmeve rajonale e Gjilanit “2online”. Burimi:

[http://www.2online.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=2036:uji-i-puseve-ne-fshatra-eshte-johigjienik&catid=71:sociale](http://www.2online.com/index.php?option=com_content&view=article&id=2036:uji-i-puseve-ne-fshatra-eshte-johigjienik&catid=71:sociale)

<sup>5</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 45. Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Albanian\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf)

<sup>6</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 44. Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Albanian\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf)

<sup>7</sup> Agjencia e lajmeve “Rajonpress”. 18.04.2013. Burimi: <http://rajonipress.com/shfleto-artikujt.php?id=9336>

“Madeleine Albright”, rruga “15 qershori”, dhe rrugë tjera vërshohen nga uji. Në këtë komunë ka disa zona të cilat janë pa kanalizim të rregulluar, si fshati Bresalc, Cernicë, Livoç, Uglar, Ponesh, Zhegoc dhe Zhegër. Pa kanalizim është edhe zona periferike e qytetit që shpie në drejtim të fshatit Malishevë. Problem me kanalizimet në Gjilan kanë edhe zonat që zyrtarisht konsiderohen se e kanë të instaluar sistemin e kanalizimeve. Banorët përgjatë rrugëve “Reshat Ymeri”, “Abdullah Presheva”, “Dëshmorët e Kombit” dhe “Adem Jashari” të cilat ndodhen në qendër të qytetit disa herë radhazi janë ankuar për bllokimin e shpeshtë të kanalizimeve.<sup>8</sup>

Përkundër premtimeve për eliminimin e kundërmimit të ujërave të zeza, edhe më tutje ky problem nuk është zgjidhur në tërësi. Banorët përskaj lumit “Stanishor”, deri në hyrje të fshatit Malishevë, përballen me problemin e kundërmimit të ujërave të zeza.

Problem i cili haset në disa lagje të qytetit është edhe mungesa e kapaciteteve të pusetave të kanalizimit, të cilat janë vjedhur nga persona të papërgjegjshëm. Në rrugën “Kadri Halimi” për afro një vit qëndrojnë pusetat e hapura, të cilat paraqesin rrezik për kalimtarët dhe shoferët e automjeteve.<sup>9</sup>

- 4. Mbeturinat.** Problem i cili shqetëson në masë të madhe banorët e qytetit të Gjilanit është edhe problemi i mbeturinave në qytet dhe jashtë tij. Problemi më i theksuar i mbeturinave është në “lagjen e romëve”, përskaj rrugëve “Abdullah Presheva”, “Elez Agushi”, “Evlia Çelebia”. Menjëherë pas luftës së 1999, romët ishin larguar dhunshëm dhe shtëpitë e tyre ishin djegur. Tani, rrënojat dhe rrugët e kësaj lagjeje janë të mbushura me mbeturina. Përveç pamjes së shëmtuar që japin shtëpitë e djegura dhe të mbushura me mbeturina, e tërë hapësira përreth kundërmon nga erërat e mbeturinave.

Përveç kësaj, problem me mbeturinat dhe kundërmimin e tyre e kanë edhe banorët e fshatit Velekincë. Mbi fshatin Velekincë, në afërsi të fshatit Uglar, në vitin 2005 është ndërtuar Deponia Rajonale e Mbeturinave. Deponia është ndërtuar me donacion të Bashkimit Evropian dhe me leje të ndërtimit nga Komuna e Gjilanit. Tani ajo menaxhohet nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina. Nga kundërmimi i erëra të kësaj deponia janë të prekur banorët e Velekincës dhe Uglarit. Mbeturinat në këtë deponi digjen dhe gjatë procesit të djegies erërat janë më të forta

<sup>8</sup> Gazeta JNK. Autor, Ardijan Lulaj. Kanalizimi vonohet, vërshon lagjet. Dhjetor 2011. Burimi:

<http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,859>

<sup>9</sup> Vizita në terren më 28 gusht 2012.

dhe kapin një rreze më të gjerë ndikimi. Banorët e fshatrave përreth derdhin mbeturinat në rrugën e cila dërgon deri tek deponia, duke bërë që një hapësirë e gjerë jashtë deponisë të jetë me mbeturina.

Nga kjo deponi kanë rrjedhur ujëra të ndotur që janë shpërndarë në burimet e ujit të pijes në fshat, nëpër ara të mbjella dhe në oborret e shtëpive të banueshme. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së (Mozaiku i Kosovës), 26% e banorëve të Gjilanit konsiderojnë se qyteti i tyre është shumë i papastër, kurse 24% e banorëve konsiderojnë se lagjja e tyre është shumë e papastër.<sup>10</sup>

**5. Mungesa e çerdheve për fëmijë.** Gjilani aktualisht ka tri çerdhe publike të cilat gjithsej sistemojnë rreth 310 fëmijë.<sup>11</sup> Numri i çerdheve dhe numri i fëmijëve që mund të pranohen gjatë një viti në këto çerdhe është tejet i vogël, ngase një numër familjesh nuk arrijë t'i sistemojnë fëmijët e tyre në çerdhet ekzistuese. Madje, Gjilani rrezikon të mbetet me vetëm dy çerdhe publike, për shkak se njëra nga tri çerdhet, që gjendet në afërsi të qendrës së qytetit, është ndërtuar në tokën shoqërore e cila administrohet nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kjo agjenci ka kërkuar disa herë radhazi nga Komuna e Gjilanit që të dislokojë çerdhen, sepse ajo pjesë e tokës do të vihet në shitje.<sup>12</sup> Prindërit në Gjilan kryesisht hasin në vështirësi për të siguruar vende pranimi në çerdhet publike të qytetit. Për më tepër, Komuna e Gjilanit në këto katër vitet e fundit nuk ka nisur ndërtimin e ndonjë çerdhe të re.

**6. Zvarritja e projekteve të nisura.** Një ndër problemet më të shfaqura gjatë viteve të fundit në Komunën e Gjilanit është mos përfundimi i projekteve të nisura, apo lënia e tyre në gjysmë. Ka dy vite që ka nisur projekti i instalimit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cernicë dhe ai nuk ka përfunduar. Kjo ka ndodhur edhe përkundër premtimit fillestar të udhëheqjes komunale që ai projekt do të përmbyllet brenda tetë muajve. Njëjtë ka ndodhur edhe me shkollën e mesme “Agim Ramadani” në Zhegër, ku punimet për renovimin e shkollës kanë zgjatur vetëm pak javë dhe pastaj punimet janë ndërprerë dhe shkolla ka mbetur e pa rinovuar. Pastaj, dinamika e punimeve në rregullimin e shtratit të lumit “Mirusha” vazhdon të mbetet problem. Ka dy vite që ka

<sup>10</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 45. Burimi: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Alb\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf)

<sup>11</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2012/2013. Fq 5. Burimi: [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Statistikat\\_e\\_Arsimit\\_neKosove\\_2012\\_13%201.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_neKosove_2012_13%201.pdf)

<sup>12</sup> Agjencia e lajmeve “Rajonpress”. Çerdhja nuk do të shitet. 2 korrik 2013. Burimi: <http://2lonline.com/politike/12610-cerdhja-nuk-do-te-shitet.html>

nisur ky projekt, por akoma është larg përfundimit. Kundërmimi i erës akoma nuk është mënjanuar, ndonëse zyrtarisht deri tani në këtë projekt janë investuar mbi 2.2 milionë euro.<sup>13</sup> Ngjashëm qëndron gjendja edhe në fshatin Livoq, ku edhe dy vite pas përfundimit të punimeve në instalimin e rrjetit të ujësjellësit, fshati nuk ka ujë. Njësoj, është zvarritur më shumë se dy vite dhe akoma konsiderohet e pa përfunduar rruga “Halim Orana” dhe Rruga “Fehmi Agani” e cila ka nisur të rregullohet në gjysmën e parë të vitit 2011. Shtresa e fundit e asfaltit akoma nuk është shtruar në këtë segment.<sup>14</sup>

**7. Madhësia e Administratës së Komunës së Gjilanit.** Komuna e Gjilanit ka gjithsej 336 persona të punësuar në administratën komunale. Në rast se do të respektohej një vendim i Qeverisë së Kosovës i 3 dhjetorit 2008, që thotë se komunat të cilat kanë nën 100 mijë banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 780 banorë, Gjilani do duhej të kishte 200 shërbyes civil, që nënkupton se Komuna do duhej të largonte nga puna rreth 136 shërbyes civil. Si pasojë e mbingarkesës së stafit me shërbyes civil dhe tejkalimin e limitit për kategorinë e pagave, në gusht 2011, Ministria e Financave kishte bllokuar për disa javë lëshimin e fondeve për Komunën e Gjilanit. Numri i shërbyesve civil në Komunën e Gjilanit ka shkuar duke u rritur nga 269 shërbyes civil sa ka qenë më 2008 në 336 më 2012. Kjo rritje e stafit ka ardhur përkundër asaj se disa shërbime janë privatizuar (siç është pastrimi dhe sigurimi fizik i objekteve). Përveç mbingarkesës së administratës me shërbyes civil, pagat e të cilëve paguhen nga kategoria e “pagave dhe mëditjeve”, Komuna e Gjilanit ka të punësuar edhe një numër të konsiderueshëm të punonjësve me “kontratë mbi vepër”, pagat e të cilëve paguhen prej kategorisë së “mallrave dhe shërbimeve”. Në periudha të ndryshme kohore, Komuna e Gjilanit ka pasur deri në 38 punonjës me kontratë mbi vepër.<sup>15</sup>

**8. Hyrja në borxh dhe rënia e të hyrave.** Komuna e Gjilanit ka përmbyllur vitin 2012 me nivelin më të lartë të borxhit nga të gjitha komunat tjera të vendit. Mbi 3.3 milionë euro vlerësohet të jetë vlera e borxhit që Komuna e Gjilanit u ka operatorëve të ndryshëm privat. Kjo komunë është e para për nivelin e lartë të

<sup>13</sup> Gazeta JNK. Autor, Kreshnik Gashi. 3 Gusht 2012. Gjilani ende kundërmon. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,2815>

<sup>14</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për dhënie të tenderëve. 2011. Komuna e Gjilanit. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=49431>

<sup>15</sup> Instituti GAP. Letërnjoftimi i Komunës së Gjilanit 2013. Fq.19-20. Burimi: [http://www.institutigap.org/documents/76619\\_LeternjoftimiGjilan2013.pdf](http://www.institutigap.org/documents/76619_LeternjoftimiGjilan2013.pdf)

borxhit. Pastaj radhitet Skenderaj, Mitrovica dhe Shtërpca.<sup>16</sup> Kjo do të zvogëlojë investimet në vitet e ardhshme në sferat kapitale. Hyrja në borxh ka ardhur si pasojë e kontraktimit të punëve dhe marrja e shërbimeve pa pasur të sigurt mbulimin financiar të tyre. Gjilani në 2012 krahas hyrjes në borxh, ka pasur edhe rënie të hyrash financiare. Kësisoj, gjatë vitit 2012, niveli i të hyrave ka qenë më i vogël për rreth 400.000 euro se në vitin 2011.

## Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Parku i qytetit.** Komuna e Gjilanit aktualisht vlerësohet të ketë një park atraktiv në qendër të qytetit i cili nga qytetarët është kërkuar të mirëmbahet. Qytetarët kanë kërkuar investime në këtë park, veçmas në shtimin e numrit të ulëseve, forcimin dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit gjatë natës, shtimin e shportave për hedhjen e mbeturinave të imta si dhe caktimin e disa personave për ruajtjen e parkut dhe mirëmbajtjen e tij.
- 2. Kalaja e Pogradjes.** Autoritetet lokale të Gjilanit nuk kanë shfaqur interesim të madh në ruajtjen e kalasë së Pogradjes. Qytetarët dhe ekspertët e trashëgimisë kulturore kanë kërkuar që kjo kala të konservohet dhe në zonën përreth saj të investohet, veçmas në infrastrukturën rrugore dhe në sistem të ndriçimit gjatë natës.

## Trendet Buxhetore në Komunën e Gjilanit


Komuna e Gjilanit në vitin 2013 do t'i ketë 18.4 milion euro buxhet apo 800 mijë euro (4%) më pak krahasuar me vitin 2010 (vit kur ka filluar mandati i kryetarit të tanishëm). Realizimi i buxhetit në vitin 2012 ka qenë 98%, ndërsa të hyrat vetanake kanë qenë 3.2 milionë euro apo 347 mijë euro më pak se në vitin 2011. Burimi kryesor i të hyrave ka qenë tatimi në pronë (30%) dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit (18%). Raporti i Auditorit<sup>17</sup> për vitin 2012 ka konstatuar se llogaritë e arkëtueshme arrijnë në 9 milion euro kryesisht për shkak të debitorëve nga tatimi në pronë dhe licencat e biznesit.

<sup>16</sup> Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit. 31 dhjetor 2012. Fq 68.

Burimi: [http://mf.rks.gov.net/Portals/0/Raporte%20dhe%20publikime/Raportet%20dhe%20Pasqyrat%20Financiare/Pasqyrat%20Financiare%202012\\_Alb.pdf](http://mf.rks.gov.net/Portals/0/Raporte%20dhe%20publikime/Raportet%20dhe%20Pasqyrat%20Financiare/Pasqyrat%20Financiare%202012_Alb.pdf)

<sup>17</sup>ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Gjilanit për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 [http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KGL\\_2012\\_Shqip\\_170869.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGL_2012_Shqip_170869.pdf)

Figure 1. Buxheti 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?gjilan/2013#/~ /gjilan>

Në grafikonin e mëposhtëm ku përshkruhen trendet e ndarjeve buxhetore për gjatë katër viteve, shohim se investimet kapitale në vitin 2013 kanë pësuar një rënie të theksueshme për 57% krahasuar me vitin 2010. Në vazhdim, deri sa në vitin 2010 këto shpenzime përbënin 37% të buxhetit, në vitin 2013 përbëjnë vetëm 16% të shpenzimeve totale. Sa i përket kontrollit të shpenzimeve, auditori ka gjetur:

- hyrje në obligime kontraktuale pa bërë zotim të fondeve;
- devijim nga tabela e investimeve kapitale të miratuar me Buxhetin e Kosovës;
- vonesa në përfundimin e punëve;
- pranimet teknike janë kryer me një rast nga nënkryetari i komunës si anëtar komisioni dhe paguar nga organizata ofertuese gjë që paraqet konflikt interesi etj.

Figure 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016 shohim se Komuna e Gjilanit në periudhën 2014-2016 planifikon të rrisë buxhetin me afër 900 mijë euro, edhe kjo rritje kryesisht pritet të financohet nga rritja e grantit qeveritar. Në anën tjetër, përveç rritjes së shpenzimeve kapitale, kategoritë tjera të shpenzimeve pritet të mbesin të njëjta.

Tabela 1. Buxheti 2014-2016

<b>Të hyrat</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
Të hyrat totale	20,125,842	20,664,893	21,089,188
Të hyrat vetanake	3,780,000	3,893,400	3,971,268
Grantet	16,345,842	16,771,493	17,117,920
<b>Shpenzimet totale</b>	<b>20,126,142</b>	<b>20,665,193</b>	<b>20,530,688</b>
Pagat dhe Mëditjet	11,734,108	11,734,108	11,734,108
Mallrat dhe Shërbimet	3,409,402	3,409,402	3,409,402
Shpenzimet Komunale	627,777	627,777	627,777
Subvencionet dhe Transferet	558,800	558,800	558,8
Shpenzimet Kapitale	3,796,055	4,335,106	4,759,401



## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të shumta për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendet buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Gjilanit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulamtiveve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.